



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

C.nr.102/20

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA NË LIPJAN, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, ne perberje prej gjykatesit Isa Gashi, me pjesmarrjen e sekretares juridike Makfirete Zhinipotoku, duke vendosur ne qeshtjen kontestimore të paditësit A. B. nga fshati D. e M. K.Lipjan, te cilin me autorizim e perfaqeson A. H. av. nga Drenasi, kundër të paditues Komuna e Lipjanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, per kompenzimin e shpenzimeve të ushqimit, vlera e kontestit 2,218.00-€, pa mbajtur seancë gjyqësore, me dt.27.09.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M
PA CAKTUAR SEANCE GJYQESORE

I. APROVOHET kërkespadia e precizuar e paditësit A. B. nga fshati D. e M. K.Lipjan si e **BAZUAR, OBLIGOHET** e paditura Komuna e Lipjanit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit te ia paguaj shumen prej 2,218.00-€, ne emer te kompenzimit per ushqim per perioden 18.04.2017 e deri me date 06.05.2022, me kamatë vjetore prej 8%, duke filluar nga data 27.09.2022 e deri te pagesa definitive, si dhe ne shpenzimet e procedurës kontestimore shumën prej 238.00-€, të gjitha këto në afat prej 15 dite nga dorezimi i aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi, permes te autorizuarit se tij, në padi, ka theksuar se ka punuar ne SHFMU “D. D.” ne fshatin D. e M. K.Lipjan, me kontrate te perhershme, dhe edhe per kunder kerkeses per kompensimin e shpenzimeve te ushqimit, konform dispozitave te Kontrates Kolektive te Arsimit te Kosoves, përkundër kalimit të qdo afati, e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin e saj. Me parashtresen per rregullimin e padise ka kerkuar qe te obligohet e paditura qe paditesit, ne emer te shpenzimeve te ushqimit t’ia paguaj

shumen prej 2,218.-€, me kamate prej 8% nga data e perpilimit te padise e deri ne pagesen definitive. I ka propozuar gjykates qe kerkespadine e paditeses ta aprovoj ne teresi si te bazuar.

Shpenzimet e procedures i ka kerkuar sipas TOAK-ës.

E paditura, ne pergjegje ne padi, e ka kontestuar bazen juridike te kerkespadise, duke theksuar se me kontraten e punes, askund nuk ceket se punetoret gezojne te drejten per ushqim, duke konsideruar se edhe sipas Ligjit te Punes punetoreve te arsimit nuk ju takojne shperblime te tilla, ndersa kontrata kolektive ne te cilen eshte thirrur paditesi, nuk ka fuqi ligjore per t'u zbatuar nga shkakun se eshte ne kundërshtim me dispozitat ligjore ne fuqi dhe e njejta vlene vetem per ata punedhenes dhe punemarres te cilet marrin persiper detyrimet e caktura me marreveshje te tilla kolektive dhe meqenese e paditura nuk eshte nenshkruese e kontrates kolektive me te dt. 18.04.2017, por nënshkruese e saj është Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në njerën anë dhe në anën tjetër është SBASHK-u, konsideron se e paditura nuk ka obligime ndaj paditësit, dhe se MASHT nuk ka bërë harmonizimin e saj me Ministrinë e Financave që të paditurës me Qarkore Buxhetore t'i lejohet ngritja e tavanit të pagave në mënyrë që të planifikojnë edhe pagesat shtesë për stafin arsimorë. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj në tërësi kërkespadinë e paditësit si të pabazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kerkuar.

Pas pranimit te pergjigjes ne padi te ushtruar nga e paditura, gjykata, konstatoi se ne mes paleve ndergjyqsore nuk ishte kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojn pengesa tjera per dhenjen e vendimit meritor, se paditesi bashke me padi ka paraqitur prova te mjaftueshme perkitazi me kerkespadine dhe lartesine e saj, dhe ate kontraten e punes me nr. te protokollit 04-112-813/1404 të dt. 01.09.2016, vertetimi per ditet e pranise ne pune leshuar nga Shkolla Filllore e Mesme e Ulet "D. D." ne fshatin D. e M. me nr. prot.2052/2 te I dates 06.05.2022, kerkesen me nr. 80238, te dates 26.12.2019, me te cilen paditesi ka kerkuar nga e paditura kompenzimin e shpenzimeve te ushqimit-shuajtes ditore, andaj konform n.398 te LPK-es, pa caktuar seance gjyqesore, muar aktgjykim me te cilin pranoj si te bazuar kerkespadine e paditesit.

Nga kontrata e punës me nr. te protokollit 04-112-813/1404 të dt. 01.09.2016, rezulton se paditësi tek e paditura, në Shkollën Filllore e Mesme e Ulet "D. D.", ne fshatin D. e M. është në marrëdhënie pune ne kohe te pacaktuar, në vendin e punës punetor teknik, me pagë bazë në lartësi prej 262.38.-€

Nga vertetimi per ditet e pranise ne pune, me nr. prot.2052/2, e dates 06.05.2022, leshuar nga Shkolla Filllore e Mesme e Ulet "D. D." ne fshatin D. e M., rezulton se paditesi prej 18.04.2017 e deri me 06.05.2022 ka gjithsej 1109 dite pune efektive.

Me kërkesen me nr. 80238, te dates 26.12.2019, paditesi ka kerkuar nga e paditura kompenzimin e shpenzimeve te ushqimit-shuajtes ditore, lidhur me te cilen kerkese e paditura fare nuk ka vendosur.

Nga keto prova, te permendura si me larte, gjykata vertetoi se paditesi eshte ne mardhenie pune ne shkollen perkatese me te cilen menaxhon e paditura, qe nga data 01.09.2016 ne vendin e punes punetor teknik, se per perioden prej dates 18.04.2017 e deri me daten 06.05.2022 ka gjithesej 1109 dite pune, se paditesi me dt.26.12.2019 ka ushtruar kerkese per kompenzim, por lidhur me kete kerkese e paditura fare nuk ka vendosur, se deri me tani e paditura nuk ia ka kompenzuar shpenzimet e ushqimit paditesit.

Me dispoziten e nenit 35.7 te Kontrates Kolektive te Arsimit ne Kosove nr. 2056 te dt. 18.04.2017 dhe Kontrates Kolektive te arsimit ne Kosove nr.105 e dt.22.04.2021, parashifet se “te punesuarve (anetar te SBASHK-ut u sigurohet kompenzimi per ushqim gjate punes, per ditet e pranise ne pune, vlere e kompenzimit te shpenzimit te ushqimit ne pune, per nje dite pune, eshte dy euro per te punesuarit qe kane mardhenjen e punes primare ne institucionet arsimore, se pundhensi I cili ka rregulluar ushqimin e te punesuarve, permes restorantit kuzhines ose ne nje forme tjeter, nuk ka obligim pagese, te te punesuarve per ushqim”. Kontrata e Kolektive e Arsimit ne Kosove nr.2056 e dt.18.04.2017 eshte ne fuqi qe nga dt.18.04.2017 ne kohezgjatje per tri vjete, ndersa Kontrata Kolektive e Arsimit ne Kosove nr.105 e dt.22.04.2021 e dt.22.04.2021 poashtu ne kohezgjatje prej tri vite.

Me dispoziten e nenit 2 te Kontrates Kolektive te Arsimit ne Kosove e cila ka hyre ne fuqi me dt. 18.04.2017, parashihet se dispozitat e kesaj kontrate kolektive, jane te zbatueshme per te gjitha te punesuarit ne te gjitha insitucionet publike dhe private te arsimit parauniversitar (para shkollor, fillor, te mesem te ulte dhe te mesem te larte, shkolla speciale e qendra te kompetences) dhe institucione te arsimit te larte ne mbare territorin e Republikes se Kosoves, te cilet jane anetare te SBASHK-ut, dispozitat e kesaj kontrate kolektive jane te zbatueshme per te gjitha punedhenesit ne sektorin e arsimit (komunal - DKA, KD te Universiteteve e institucioneve te arsimit te larte, MASHT-in etj) ne sektorin publik dhe institucionet edukativo – arsimore private ne mbare territorin e Republikes se Kosoves.

Mbi gjendjen faktike të vërtetuar, e bazuar dispozitat e lartpërmendura të Kontrates Kolektive te Arsimit ne Kosove, gjykata gjeti se kërkespadia e paditësit për kompenzimin e shpenzimeve te ushqimit, është e bazuar, për qka edhe e aprovoi në tërësi kërkespadinë e paditësit si të bazuar, si ne dispozitiv te ketij aktgjykimi.

Lartësinë e kërkespadiës, gjykata e caktoi duke pasur parasyshë kriteret e caktuar me Kontratat Kolektive te Arsimit ne Kosoves te siperpermendura, dhe ditet e pranise ne pune te paditesit prej 1109 dite pune e shumezuar per 2€ per nje racion te ushqimit per nje dite pune, dhe aprovoi kerkespadiene per ushqim gjate punes per perioden prej dt.18.04.2017 e deri me daten 06.05.2022 ne lartesi prej 2,218.-€ (1109 dite pune x 2 euro per nje shuajt ditore = 2,218.-€)

Vendimin për kamatën, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata e bazoi në dispozitën e nenit 382.2 të LMD-ës (Gazeta Zyrtare e RK-ës Ligji nr.04/L-077), dhe gjykoj kamatë vonesën prej ditës kur ka marr aktgjykimin e deri tek pagesa definitive.

Gjykata i vlerësoi edhe kundërshtimet e palës së paditur, se me Ligjin e Punës askund nuk janë paraparë këto shpërblime, por të njëjtave nuk u'a fali besimin, nga se një e drejtë e tillë për pagesën e, kompensimin e ushqimit, parashihet me Kontrata Kolektive te Arsimit ne Kosove, ku decidivisht është paraparë e drejta e punëtorit ne kompenzimin e shpenzimeve teushqimit, dhe kontrata kto te cilat jane obligative edhe për të paditurën si punëdhënëse.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës gjykata e mori duke u bazuar në nenin 452 par. 1 dhe 2 te LPK-ës, dhe me që paditësi ka pasur sukses në procedurë, gjykata i'a njohu shpenzimet për hartimin e padisë shumë prej 104.00-€, për përpilimin e parashtresës për precizim të padisë shumë prej 104.00-€, sipas TOAK-së, si dhe për taksë për padi në shumë prej 30.00-€, këto në shumë të përgjithshme prej 238.00-€.

Nga të theksuarat më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË LIPJAN

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil

C.nr.102 /2020, datë 27.09.2022.

GJYKATËSI

Isa Gashi

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtijë aktgjykimi pala e pakanaqur ka të drejtë të ushtrojë ankesë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e dorëzimit. Ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e cila ushtrohet nëpërmes të kësajë gjykate.